



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 223/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: N.T.P. “Fidanishtja Gjelbërimi” & N.T.P. “Las Pallmas” - Malishevë, kundër njoftimit të dhënies së kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Krijimi i hapësirave gjelberuese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ - Lot 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Rahovecit, më datën: 17.04.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: N.T.P. “Fidanishtja Gjelbërimi” & N.T.P. “Las Pallmas” - Malishevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Krijimi i hapësirave gjelberuese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ - Lot 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Rahovecit.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelberuese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ - Lot 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Rahovecit.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomike ankues N.T.P. “Fidanishtja Gjelbërimi” & N.T.P. “Las Pallmas” - Malishevë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operoret ekonomik ankues N.T.P. "Fidanishtja Gjellbërimit" & N.T.P. "Las Pallmas" - Malishevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.04.2020 me nr. 223/20, kundër njoftimit për shpërbllim me kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi i hapësirave gjelberuese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ - Lot 1", me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Rahovecit. duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,6,7,59,60,69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.04.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.04.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: - Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69, dhe 72 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë, dhe ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar më parë dhe e konsideroj si çështje të gjykuara "resjudikata", mirëpo duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe vendimin nga PSH .nr. 683/19 të datës 19.11.2019 dhe urdhëresës nga PSH .nr. 949/19 të datës 31.01.2020, dhe vendimi nga PSH.nr.105/20 të datës 11.03.2020, konsideroj se grupi i OE ankues, nuk ka arritur të dëshmojë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues - Komuna e Rahovecit, në pajtim të nenit 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, e të cilin thuhet: 1.26. Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, andaj pretendimet e grupit të OE ankues, nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.



Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si ne vijim: Është përgjegjësi, dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues, ZPP, respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje tenderët, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kritereve te përzgjedhjes dhe kriterit te shpërblimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1 ne dosjen e tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit te OE ankues, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon të mbetet ne fuqi B58 - njoftimit mbi vendimin AK.

Autoriteti Kontraktues, me date: 10.04.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues me datë: 11.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ankues N.T.P. "Fidanishtja Gjelbërimi" & N.T.P. "Las Pallmas" - Malishevë se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69, dhe 72 të LPP-së. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë dhe ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar më parë, kjo çështje konsiderohet si "resjudikata". Mirëpo, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe vendimin nga PSH .nr. 683/19 të datës 19.11.2019 dhe urdhëresës nga PSH .nr. 949/19 të datës 31.01.2020, dhe vendimi nga PSH.nr.105/20 të datës 11.03.2020, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se grupi i OE ankues, nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues - Komuna e Rahovecit, në pajtim të nenit 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, ku thuhet: "*1.26. Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo*

*person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”.*

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se është përgjegjësi dhe në diskrecion të autoritetit kontraktues, zyrtarit përgjegjës të prokurimit, respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoj tenderët, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterit të shpërblimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1 në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në bazë të sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Blerim DINA



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK Autoritetit Kontraktues –Komunës së Rahovecit;
- 1x1 OE ankues - N.T.P. “Fidanishtja Gjelbërimi” & N.T.P. “Las Pallmas” - Malishevë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.